



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05/ 203

24/07/2018

Podujevë

Bazuar në nenet 7 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-032, Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, i datës 19.10.2017, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 10/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 20/07/2018, si dhe kërkesave e nevojave për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Podujevës, Drejtoria e Arsimit shpall:

Konkurs për mësimdhënës për vitin shkollor 2018/2019

1. **Shfmu “Naim Frashëri” Podujevë**
 - Një mësimdhënës të programit fillor
2. **Shfmu “Enver Maloku” Podujevë**
 - Një mësimdhënës të programit fillor, me kohë të caktuar
3. **Shfmu “Jetullah Islami” Dyz**
 - Tre mësimdhënës të programit fillor
4. **Shfmu “Eqrem Çabej” Buricë**
 - Dy mësimdhënës të programit fillor (njëri zëvendësim deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë)
5. **Shfmu “Kadri Kadriu” Llaushë**
 - Tre mësues të programit fillor (Shkolla amë – Llaushë)
 - Një mësimdhënës të programit fillor (Llaushë e Poshtme)
 - Dy mësues të programit fillor (Dumnicë e Epërme)
6. **Shfmu “Naum Veqilharxhi” Llapashticë e Epërme**
 - Një mësimdhënës të programit fillor
7. **Shfmu “Lagush Poradeci” Dumnicë**
 - Një mësimdhënës të programit fillor
8. **Shfmu “Jahë Hasani” Bervenik**
 - Dy mësimdhënës të programit fillor me klasë të kombinuara
9. **Shfmu “Luigj Gurakuqi” Batllavë**
 - Një mësimdhënës të programit fillor (Gërdofcit)
10. **Shfmu “Dituria” Llapashticë e Poshtme**
 - Një mësimdhënës të programit fillor

11. Shfmu “Elfir Behrami” Metehi

- Një mësimdhënës të programit fillor (zëvendësim deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lindjes)

12. Shfmu “Rilindja” Herticë

- Katër mësimdhënës të programit fillor (shkolla amë – Herticë)
- Dy mësimdhënës të programit fillor me klasë të kombinuara (Surdull)

13. Shfmu “Esad Mekuli” Dobratin

- Një mësimdhënës të historisë për 10 orë

14. Shfmu “Kongresi i Manastirit” Gllamnik

- Një mësuese të programit fillor (zëvendësim deri sa të kthehet punëtorja nga pushim i lindjes),
- Një mësimdhënës për punë me fëmijë me nevoja të veçanta (zëvendësim deri sa të kthehet punëtorja nga pushim i lindjes)

15. Shfmu “Pavarësia” Sibofc

- Një mësimdhënës të programit fillor

16. Shfmu “Shefki Kuleta” Tërrnavë

- Dy mësimdhënës të programit fillor (Bellopojë),
- Një mësimdhënës të programit fillor (Halabak)

17. Shfmu “Zahir Pajaziti” Orllan

- Dy mësimdhënës të programit fillor në Brainë (njëri me kohë të caktuar, deri sa të kthehet punëtorja nga pushim i lindjes)

18. Shfmu “Drita” Majc

- Tre mësimdhënës të programit fillor, dy prej tyre me klasë të kombinuara (Lupç i Epërm),
- Dy mësimdhënës të programit fillor me klasë të kombinuara (Popovë)

19. Shfmu “Sami Frashëri” Zhiti

- Një mësimdhënës të programit fillor me klasë të kombinuara (Zhiti)
- Një mësimdhënës të programit fillor me klasë të kombinuara (Murgull)

20. Shfmu “Emin Duraku” Bajçinë

- Një mësimdhënës të programit fillor

21. Shfmu “Nuhi Gashi” Bradash

- Një mësimdhënës të programit fillor
- Tre mësimdhënës të edukatës muzikore për 47 orë në shkolla fillore dhe të mesme të ulëta:
 - Shfmu “Nuhi Gashi” 8 orë
 - Shfmu “Kadri Kadriu” 8 orë
 - Shfmu “Shefki Latifi” 4 orë
 - Shfmu “Jahë Hasani” 4 orë
 - Shfmu “Elfir Behrami” 4 orë
 - Shfmu “Zahir Pajaziti” 4 orë
 - Shfmu “Sami Frashëri” 7 orë
 - Shfmu “Jetullah Gashi” 4 orë
 - Shfmu “Jetullah Islami” 4 orë

22. Gjimnazi “Aleksandër Xhuvani” Podujevë

- Një mësimdhënës të gjuhës gjermane, 18 orë në gjimnaz,
- Tre mësimdhënës të gjuhës gjermane (si gjuhë e dytë e huaj) në shkolla të mesme të ulëta nëpër shkolla në fshatra

23. Shfmu “Shaban Shala” Podujevë

- Një punëtor teknik - pastrues

24. Shfmu “Musli Dumoshi” Dumosh

- Një punëtor teknik – pastrues

KUSHTET:

I. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve, zyra nr. 14 e komunës),
- Certifikata e lindjes,
- Dokumentin personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje),
- Dëshmi mbi kualifikimin (kopja e vërtetuar),
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT,
- Dëshmi mbi përvojën e punës,
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatët të cilët pranohen në marrëdhënie pune, pra pas publikimit të rezultateve).
- **Sqarim shtesë:**
 - Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente,
 - Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHT,
 - Në intervistë ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit sipas U. A. (MASHT) nr. 10/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 20/07/2018, por në mungesë të kuadrit adekuat mund të ftohen edhe kandidatët me kualifikim të përafërt,
 - Kandidatët që konkurrojnë në dy pozita do të intervistohen vetëm për njëren pozitë e që intervista vlen për të dy pozitat,
 - Intervista me kandidatë për mësimdhënës mbahet në shfmu “Dr. Ibrahim Rugova” Podujevë, sipas orarit të intervistimit i cili do të publikohet me kohë në tabelën e shpalljeve të Komunës së Podujevës (në hyrje të objektit të komunës),
 - Dokumentet nuk kthehen.
- **Afati i konkursit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, deri më datë 08/08/2018.

Drejtori

Agim Blakçori, MSc,

